



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI I LËNDËS
Letërsi e gjuhë B (3)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione / 20 seminare

Viti / Semestri : Viti III, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kjo lëndë synon të informojë studentin në lidhje me zhvillimet e letërsisë turke gjatë shek. XIX e në vazhdim deri në shpalljen e Republikës së Turqisë në vitin 1923. Kjo periudhë karakterizohet nga zhvillimi i letërsisë turke nën ndikimin e letërsisë perëndimore. E karakterizuar me luhatje të shumta të ndikuara nga zhvillimet politike kjo periudhë paraqet lëvizjen e letërsisë turke nga boshti oriental i cili kishte dominuar letërsinë turke në gati 10 shekuj në drejtimin e letërsisë perëndimore evropiane e më tej. Rryma të reja, përplasje ideologjish politike dhe nacionaliste janë një dukuri e zakonshme e kësaj periudhe

Objektivat specifike lëndore:

1. Njohuri mbi zhvillimin e letërsisë turke në shek. XIX.
2. Njohuri mbi rrymat e ndryshme që lindin në mesin e Shek. XIX dhe në fillimet e Shek. XX.
3. Njohuri mbi shkrimtarët kryesorë të letërsisë së Tanzimatit.
4. Njohuri mbi shkrimtarët kryesorë të letërsisë së rrymës Serveti Funun.
5. Njohuri mbi shkrimtarët kryesorë të letërsisë nacionaliste

Rezultatet e pritshme :

1. Përshkruajë zhvillimin historik të letërsisë turke nga shekulli XIX deri në shpalljen e Republikës së Turqisë, duke kuptuar ndikimet perëndimore dhe ndryshimet ideologjike të kësaj periudhe.
2. Identifikojë rrymat letrare kryesore të periudhës, si Tanzimati, Servet-i Fünun, letërsia nacionaliste dhe ajo e luftës për pavarësi, si dhe të analizojë kontekstin e lindjes së tyre.
3. Njohë dhe analizojë autorët më përfaqësues të secilës rrymë letrare, duke kuptuar kontributin e tyre në transformimin e letërsisë turke drejt modelit modern evropian.